

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 887 Prot.

Gjirokastrë, më: 22 / 07 / 2020

**V E N D I M**

**Nr. 11. Dt. 22. 07. 2020**

Bazuar në nenin 6, pika 2, nenin 34, pika 6, 7 dhe 8 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, KIZ

**V E N D O S I**

1. Në fund të procesit të votimit, pasi të kryhen veprimet sipas pikës 1 deri në pikën 4, të nenit 34 të Rregullores, dhe para se të fillojë verifikimi dhe numërimi i fletëve të votimit nga KZF<sup>ja</sup>, kutia e votimit për secilën kategori për autoritetet dhe organ drejtues do të shërbejë si kuti për materialet zgjedhore për kategorinë respektive.
2. Pas verifikimit dhe numërimit të votave të trupës zgjedhore "Student", për kategorinë autoritet drejtues "Rektor" dhe "Përgjegjës i njësisë kryesore" (Dekan), të gjitha materialet zgjedhore të kësaj trupe do të futen në të njëjtën kuti të materialeve zgjedhore të Personelit akademik.
3. Në përfundim të procesit, anëtarët e secilës KZF<sup>je</sup> do të shoqërojnë dhe do të dorëzojnë pranë KIZ, pesë kuti votimi tashmë të shndërruara në kuti të materialeve zgjedhore, sipas kategorive:
  - Kutia me materialet zgjedhore "Rektor"
  - Kutia me materialet zgjedhore "Dekan"
  - Kutia me materialet zgjedhore "Përgjegjës i njësisë bazë"
  - Kutia me materialet zgjedhore "Senat akademik" trupa zgjedhore "Personel akademik"
  - Kutia me materialet zgjedhore "Senat akademik" trupa zgjedhore "Student"
4. Kutitë e materialeve zgjedhore të cituara më sipër, para shoqërimit dhe dorëzimit në KIZ, të mbyllen me vulat e sigurisë, të cilat shënohen në procesverbal.

**K R Y E T A R I**

(Emër Mbiemër Firma)

Majlinda Bobrosh  
Bobrosh

**ANËTAR**

(Emër Mbiemër Firma)

Famira Boboli

**ANËTAR**

(Emër Mbiemër Firma)

Milosh Jure

**ANËTAR**

(Emër Mbiemër Firma)

Klara Jure

**ANËTAR**

(Emër Mbiemër Firma)

\_\_\_\_\_